

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANE
ZYRA NOTERISE TIRANE
Noter Erjon B.BARDHI

Nr. 2553 Rep

Nr. 1099 Kol

KONTRATE SHITJE KUOTASH



Taksa e pulles e paguar.

Sot më datë 06/09/2019 (dymijë e nentembëdhjetë) para meje Noter Erjon B.Bardhi anëtar i Dhomës së Noterëve Tirane i regjistruar pranë Organeve Tatimore QKB me numer Nipti L62227014R ,në zyrën noteriale të ndodhur ne "Rr.Kongresi i Permetit"Zogu i Zi,perballe Ring Center,Tirane u paraqiten personalisht palet e meposhtme te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje:

PALA SHITËSE: KOSTANDIN QIRJAZI atesia **LLAMBI** i lindur ne Kreshove,Kolonje me datë **03.04.1960** dhe banues ne Rr.Ali Begeja,pall 14,shk 1,ap 12 , **Tirane** madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar mbajtes i leternjoftimin me nr personal **G00403145J** me date leshimi 28.12.2009.ne cilesine e ortakut te **1** kuote me pjesemarrje ne perqindje **8 %** te kapitalit themeltar te **Shoqërisë "ASL" shpk. në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi"**);

PALA BLERESE: FATMIR ISUFAJ atësia Shyqyri i lindur në Potom,Skrapar më datë 13.05.1975 dhe banues në Njesia Bashkiake nr 9,rruga Jordan Misja, Tiranë madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me Leternjoftimin me nr personal H50513171R (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësit dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

Kushtet paraprake

- A) Shitësi është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 8% (tetë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "ASL" Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, NUIS L81310025T, me seli në Rruga Kongresi i Manastirit, Njësia bashkiake nr. 3, zona kadastrale nr. 8140, nr. pasurie 3/967, Tiranë, Shqipëri (në vijim referuar edhe si "Shoqëria");
- B) Blerësi është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 28% (njetzet e tete për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- C) Shoqëria ka për objekt "NDERTIM GODINA SHUMEKATESHE SHERBIME KOMPLEKSE DHE BANIMI" dhe është pajisur me leje ndertimi:
 - 1.1 **Leja e ndërtimit me Nr. Prot. E-18807/7** të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë datë 11.10.2018, objekti "Godine banimi dhe shërbimesh 11 kat dhe 2 kate parkimi nëntokë, në pronë të znj:Nadire Kepi ne adresën: Rruga "Kongresi i Manastirit"njësia Administrative nr 3,Tirane.
 - 1.2 **Leja e ndërtimit me Nr. Prot. E-29298/9** të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë datë 04.03.2019, objekti "Godine banimi dhe shërbimi dhe hoteleri 11 kat dhe 2 kate parkimi nëntokë, në pronë të znj:Nadire Kepi ne adresën: Rruga "Kujtim Laro"njësia Administrative nr 3,Tirane.
 - 1.3 **Leja e ndërtimit me Nr. Prot. X-6411/3** të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr prot X-6411/2, objekti "Godinë banimi dhe shërbimi 1 dhe 9 kat me 2 kat parkim nëntokë dhe godinë banimi dhe shërbimi 3 dhe 9 kat me 2 kate parkim nëntokë"në pronë të

familjes Kokonozi, Uznova, Suzana Shatku, Lindita Pocesta, ne adresën: Rruga "Kongresi i Manastirit" njesia Administrative nr 3, Tirane. bashkëlidhur kësaj Kontrate si shtojca 1.

- D) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 1 (nje) kuote e barabartë me 8% (tetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si "Kuota"), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- E) Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi 1 (nje) Kuotë e barabartë me 8% (tetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;
- F) Palët deklarojnë dhe pranojnë shprehimisht se përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, të gjithë ortakët e Shoqërisë janë njoftuar për shitjen e Kuotës sipas dispozitave të statutit dhe se ato nuk kanë ushtruar të drejtën e parablerjes, përveç Blerësit, i cili nënshkruan këtë Kontratë;
- G) Më datë 09/05/2019 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, ka miratuar transferimin e Kuotës.
- Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Kushtet paraprake

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

Neni 2

Shitja e kuotës

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi bie dakort te shese, transferoje dhe dorezoje 1 (nje) kuote e barabarte me 8% (tetë për qind) te kapitalit themeltar qe ai zoteton ne shoqerine "ASL", të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.
- 2.2. Shitja dhe transferimi i titullit te kuotes behet me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe dorezimin e kuotes tek bleresi, i cili merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shitesit dhe ne veçanti te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise, per te ndare pasurine e shoqerise si dhe merr persiper detyrimet dhe pasivet e mundeshme. Palet bien dakort se pagesa e çmimit do te behet sipas percaktimeve te nenit 3 te kesaj kontrate.
- 2.3. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë "ASL" do te jete:
1. FATMIR ISUFAJ zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 36 % te kapitalit themeltar te Shoqërise "ASL" shpk
 2. ARMAND LILO zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 60 % te kapitalit themeltar te Shoqërise "ASL" shpk
 3. ALKET MESLANI zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 4 % te kapitalit themeltar te Shoqërise "ASL" shpk

Neni 3

Çmimi

Çmimi i shitjes i pasurise objekt i kësaj kontrate shitje do te jete ne vleren 102 000 (njeqind e dy mije) euro e cila do te paguhet ne natyre (ne siperfaqe ndertimi) nga pjesa takuese e ortakut Fatmir Isufaj tek objekti qe po ndertohet sipas lejes se ndertimit me nr Prot. E-18807/7 të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë datë 11.10.2018, dhe konkretisht pasurite:

- 1) "Apartament" me siperfaqe totale prej 105 m2 (njeqind e pese) meter katerore nga kjo 92.2 m2 (nentedhjte e dy presje dy) metra katerore siperfaqe ndertimi dhe 12.8

m² (dymbëdhjete presje tete) metra katerore sipërfaqe e perbashket me perberje (2+1) kuota +32.55 e ndodhur ne shkalla 3,kati 8 banim, Apartamenti nr 38 sipas planimetrise qe i bashkengjitet kesaj kontrate.

- 2) "Apartament" me sipërfaqe totale prej 65 m² (gjashtëdhjete epese) meter katerore nga kjo 57.1 m² (pesëdhjete e shtate presje nje) metra katerore sipërfaqe ndertimi dhe 7.9 m² (shtate presje nente) metra katerore sipërfaqe e perbashket me perberje (1+1) kuota +32.55 e ndodhur ne shkalla 3,kati 8 banim, Apartamenti nr 37 sipas planimetrise qe i bashkengjitet kesaj kontrate.

z.Kostandin Qirjazi me nenshkrimin e kesaj kontrate do te behet pronar i pasurive te mesiperme, te cilat do te merren ne dorezim nga z.Kostandin Qirjazi me mbarimin e punimeve sipas lejes se ndertimit.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci të Shitësit

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3 Blerësi deklaron se blen Kuotën e Shitësit, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 4.4 Shitësi me nenshkrimin e kesaj kontrates nuk ka dhe nuk do te kete asnje pretendim ne lidhje me 1 (kuote) e barazvlefshme me 8% (tete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise "ASL" qe ai zoteronte, dhe pronar i vetem dhe legjitim pa asnje barre dhe detyrim ndaj te treteve behet blerësi z. FATMIR ISUFAJ.
- 4.5 Kjo kontrate do te jete e detyrueshme dhe do te kete pasoja juridike ndaj paleve, trashegimtareve te tyre, si dhe ndaj atyre te cileve iu eshte ceduar ne menyre te rregullt,

Neni 5

Shpenzimet dhe taksat

- 5.1 Shpenzimet ligjore dhe taksat, shpenzimet noteriale, tarifat e regjistrimit në zyrat kompetente si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të jenë në ngarkim të Blerësit z.Fatmir Isufaj.
- 5.2 Shpenzimet noteriale per Kontraten e shit-blerjes per pasurite e mesiperme ,Taksen e kalimit te pasurise se pronesise mbi te drejten e transferimit te pasurise (parashikuar nga ligji nr 9632 date 30.10.2006)per sistemimin e taksave vendore, Lidhja e kontratave me "OSHEE" (Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike) "Ndermarrja Ujesjelles Kanalizime" dhe shpenzimet e tjera administrative te lidhura me te jane ne ngarkim te perfituesit te tyre z.Kostandin Qirjazi.
- 5.3 Blerësi merr persiper te paguaje shpenzimet e tjera sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 6-Interpretimi i kontratës

Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Nese pjese te kesaj kontrate jane ose behen te pavlefshme ose jodetyruese, palet do te jene te detyruara te zbatojne pjesen tjeter te kontrates, Ne kete rast, palet do te zvendesojne pjesen e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime te vlefshme e detyruese efektet e te cilave sipas permbajtjes dhe qellimeve te kesaj kontrate duhet te jene ne kufijte e te mundshmes, e ngjashme me pjesen e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 7- Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këtë nen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 8

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Paleve.

Neni 9

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e 1 (nje) kuote e barazvlefshme me 8 % (tete perqind) te kapitalit themltar qe zoteron shitesi, tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklarimet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

Neni 10

Anekset e kontrates

Kesaj kontrate i bashkëngjiten si pjese perberese dhe te pandara keto dokumenta qe do te quhen Anekse te kontrates. **Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkangjitur:**

- Ekstrakti i Regjistrit Tregetar
- Lejat e Ndertimit
- Vendimit e lejave te Ndertimit
- Planimetri e Aparatamenteve
- Kopje te leternjoftimeve te personave nenshkrues
- Vendimi i Asamblese se Pergjithshme.

Unë noter Erjon B.Bardhi, hartova këtë kontratë, në 4(kater) kopje ne gjuhën shqipe, që pasi u lexua nga ana ime dhe palët pjesëmarrëse, të cilat deklaruan para meje së është konform vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar, në shenjë pranimit e nënshkruan në praninë time. Duke qenë i bindur për identitetin e palëve dhe vullnetin e tyre të lirë unë Noter **Erjon B.Bardhi** e legalizoj aktin e mësipërm në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin me nr 110/2018 date 20.12.2018 "Për Noterinë" në 4(kater) kopje me vlerë të njëjtë, nga të cilat,nje kopje dorezohet prane QKB-se, nje kopje i jepet palës blerëse, nje kopje palës shitëse dhe një kopje administrohet nga ana ime,prane kesaj zyre Noterie.

PALET KONTRAKTUESE

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:

PALA SHITËSE
KOSTANDIN QIRJAZI

Kostandin Qirjazi

NOTER
ERJON B.BARDHI

Erjon Bardhi

PALA BLERËSE
FATMIR ISUFAJ

Fatmir Isufaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81310025T
2. Data e Regjistrimit	10/01/2018
3. Emri i Subjektit	ASL
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	08/01/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 08/01/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative nr.3, Rruga Kongresi i Manastirit, Zona Kadastrale nr.8140, nr pasurie 3/967
8. Kapitali	100,000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	4,00
9. Objekti i aktivitetit	Zbatim, projektim te ndertimeve civile, ekonomike, punime dheu, sistemim taracime, prodhime elementesh te parafabrikuara, betoni e beton arme, ndertime civile e turistike, rruges, vepra arti, hekurudha e kanalizime, punime karperterie, investime ne sektorin e energjetikes. Pastrimin dhe administrimin e ambjenteve te perbashketa (ne bashkepronesi) ne ndertesat e banimit, objekteve civile. Prodhim e tregtim me shumice e pakice te materialeve te ndertimit, inerte, rere, gure, zhavor, blloqe betoni, parafabrikate, prodhim guresh, rere cakull, panel betoni, lende druri, dru zjarri dhe shitja e tyre dhe aktivitete te ndertimit. Prodhimin e artikujve te pasticerise, embelsirave, te brumrave dhe te lendeve te para dhe shitjen e tyre. Palester. Real Estate/ zyra imobiliare. Import, eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme ku perfshihen mallra ushqimore, mallra industriale, vere, pije alkolike dhe joalkolike, kafe, caj, tregtim dhe sherbim te tyre ne ambjente te ndryshme. Komisione dhe perfaqesime te personave juridike e fizike. Aktivitete ne sektorin e turizmit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

hapjen e agjencive te udhetareve e udhetime turistike, restorant dhe hoteleri, transporte te ndryshme. Manaxhim dhe administrim te sherbimeve te ndryshme publike e private. Ndertim lulishtesh dhe parqesh gjelberimi, realizim pyllzimesh, ndertime vepra hidroenergjitike, prodhim dhe shperndarje te energjise elektrike. Konsulence Biznesi, Financiare, Fiskale, Ligjore, Marketingu Teknologjie Informacioni, Telekomunikacioni, Doganore, Sistemesh Cilesie, Burimesh Njerezore dhe Kerkim tregu. Projektim, zhvillim dhe tregtim te projekteve te ndryshme, teknologjike dhe sociale, mbeshtetese per veprimtarine baze te vete shoqerise si dhe te klienteve te saj. Ndermjetesimin tregtar, prodhim dhe shitje ne sektorin e karburanteve dhe nenprodukte te tyre. Projektim dhe zbatim te punimeve te ndertimit te sistemeve te ngrohjes dhe ftohjes, ventilimit dhe klimatizimit. Eksport-import dhe tregtim me shumice e pakcie te te gjitha llojeve te materialeve dhe pajisjeve te ndertimit, hidrosanitare, elektrike, te mallrave te ndryshem industriale dhe mallra te te gjitha llojeve. Projektme Masterplane, Projektim - zbatim konstruktiv. Projektim - zbatim te objekteve te ndryshme me konstruksione metalike. Projektim dhe rlevime per bazamente gjeodezike, projektme topografike dhe hartografike dhe fotogrametike. Studime gjeologo - inxhinierik i truallit per te gjitha llojet e objekteve. Projektme te sinjalizimit rrugor. Projektim Arkitektonik: objekte civile, industriale, spitalore, turistike, vepra arti ne infrastrukture, kulti, administrative, interieri, peisazhi, hoteleri, siperfaqe te gjelberta, parqe, lulishte, restaurim i monumenteve te kultures. Projekte Adaptimi. Dizenjim grafik, Animacion, Modelim, renderizim. Perpunim grafik projektesh: Animacion, Modelim, Renderizim, Perpunim arkitektonik planimetrish. Projektim Konstruktiv: objekte civile, industriale, spitalore, turistike, vepra arti ne infrastrukture, kulti, administrative, perpunim konstruktiv, projektim objektesh me shkalle te larte veshtiresie beton arme, metalike troje e shpate me qendrueshmeri te larte. Projektim instalator: Instalime hidrosanitare. Linja e rrjete elektrike - telefonike - radiotelefoni - citofoni - sistem alarmi - televiziv etj, per objekte civile, industriale, turistike. Projektim veprash hidraulike: Diga - galeri - tunele hidraulike. Projektim i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	prodhimit dhe shperndarjes se energjise ne: Centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare). Studime / vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet ku ndertohen objekte te infrastruktures rrugore dhe hekurudhore te te gjitha llojeve, ura, tunele, etj. Studime/vleresime te sizmologjise inxhinierike per trojet ku ndertohen objekte komplekse si: hidrocentrale (per çdo fuqi te instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele per vepra hidroteknike, bazamente per ngarkesa te medha dhe objekte industriale.	
10. Administratori/ët	Eduart Liçi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 24/05/2018	Deri: 24/05/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Kostandin Qirjazi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 8.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	8,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	Fatmir Isufaj	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 28.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	28,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Ortakët	Armand Lilo	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 60.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	60,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

15. Ortakët	AlketMeslani	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 4.000,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	4,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	E-Mail: aslshpk1@hotmail.com Telefon: 0692020810	
18. Statusi:	Aktiv	

Datë: 06/05/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga

Web



NR. 2, DATË 03/05/2019

SHOQËRIA:

“ASL” sh.p.k

NIPT: L81310025T

Adresa: Njesia Administrative nr.3, Rruga Kongresi i Manastirit,
Zona Kadastrale nr.8140, nr pasurie 3/967, Tirane.

**VENDIM
I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TE SHOQËRISË TREGTARE**

“ASL” sh.p.k

Sot, më datë 03/05/2019 bazuar dhe në mbështetje të statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” u thirr dhe mbajt në selinë kryesore të shoqërisë “ASL” sh.p.k e regjistruar më datë 10.01.2018 dhe NIPT: L81310025T, me adrese Njesia Administrative nr.3, Rruga Kongresi i Manastirit, Zona Kadastrale nr.8140, nr pasurie 3/967, Tirane, mbledhja e Asamblesë e Ortakëve të shoqërisë, mbledhje e thirrur nga Ortaku z. KOSTANDIN QIRJAZI.

Ortakë të pranishëm: Shoqëria “ASL” sh.p.k zotërohet nga:

1. **KOSTANDIN QIRJAZI** zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 8 % te kapitalit themeltar te Shoqërise “ASL” shpk;
2. **FATMIR ISUFAJ** zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 28 % te kapitalit themeltar te Shoqërise “ASL” shpk;
3. **ARMAND LILO** zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 60 % te kapitalit themeltar te Shoqërise “ASL” shpk
4. **ALKET MESLANI** zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 4 % te kapitalit themeltar te Shoqërise “ASL” shpk

Mbledhja mori në shqyrtim çështjet e përfshira në rendin e ditës mbi:

- **Shitjen e 1(nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 8 % (tete perqind) te kapitalit themeltar te Shoqërisë qe zoteron ortaku z.KOSTANDIN QIRJAZI tek bleresi z.FATMIR ISUFAJ.**

Pasi u konfirmua prania fizike e ortakëve të sipërcituar asambleja mori në shqyrtim çështjet për diskutim në përputhje me statutin e shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me vendim unanim Asambleja e ortakëve të shoqërisë.

VENDOSI:

- **Miratimin e shitjes se 1(nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 8 % (tete perqind) te kapitalit themeltar te Shoqërisë qe zoteron ortaku KOSTANDIN QIRJAZI tek bleresi z.FATMIR ISUFAJ.**

Pra Blerësi, Z. Fatmir Isufaj, do të bëhet pronarë e 1 (një) kuote që përbën 36 % të kapitalit themeltar të shoqërisë “ASL” Sh.p.k, ndërsa Ortakët e tjerë do të ngelen pronarë të:

- Ortaku Themelues Z.Armand Lilo: Zotërues i 1 (një) kuote që përbën 60 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Ortaku Themelues Z.Alket Meslani: Zotërues i 1 (një) kuote që përbën 4 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Ky vendim u hartua në tre kopje të barazvlefshme dhe u nënshkrua rregullisht nga Ortakët prezent ne Mbledhje.

**VENDIM
I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TE SHOQËRISË TREGTARE**

KOSTANDIN QIRJAZI

Kostandin Qirjazi

FATMIR ISUFAJ

Fatmir Isufaj

ARMAND LILO

Armand Lilo

ALKET MESLANI

Alket Meslani





Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit:	D-20190506940954
Data e Rezultatit te Kerkimit:	06.05.2019
Ora e Rezultatit te Kerkimit:	9:40:09AM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-613-3180
Referenca e Perdoriesit:	



LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0


KOSTANDIN LLAMBI QIRJAZI
ASL SH.P.K.




Alisa Ilaku



Planimetria e mobilimit te apartamentit Nr. 37 (1+1), Shkalla 3, Kati 8 i banimit,
Kuota +32.55 (shk. 1:100)



RENDER



"ASL" sh.p.k.

POZICIONI I APARTAMENTIT Nr.37




TABELA E TE DHENAVE

Planimetria e mobilimit te apartamentit Nr. 37
 (shk. 1:100)


Apartamenti 1+1, Nr.37	
Ambjenti	Superfaqja
1. Sip	= 57.1 m ²
2. Sip.e perbashket	= 7.9 m ²
3. Sip.torrens	= 65.0 m ³

PLANIMETRIA E APARTAMENTIT NR.37, KATI 8 I BANIMIT, SHKALLA 3 sh 1:100






Planimetria e mobilimit te apartamentit Nr. 38 (2+1), Shkalla 3, Kati 8 i banimit,
Kuota +32.55 (shk. 1:100)



"ASL" sh.p.k.

RENDER



POZICIONI I APARTAMENTIT Nr. 38




TABELA E TE DHENAVE

Planimetria e mobilimit te apartamentit Nr. 38
 (shk. 1:100)

Apartamenti 2+1 Nr.38	
Ambjenti	Superfaqja
1. Sip =	92.2 m ²
2. Sipe perbashket =	12.8 m ²
3. Sipe totale =	105.0 m ²

3698 forward

3698 forward



PLANIMETRIA E APARTAMENTIT NR.38, KATI 8 I BANIMIT, SHKALLA 3 sh 1:100



LEJE NDËRTIMI

Nr. Prot. E-18807/9

Miratur me Vendim të Kryetarit të Bashkisë E-18807/ 7, datë 11.10.2018

ZHVILLUES:

Shoqëria "ASL" sh.p.k.

SUBJEKT NDËRTUES:

Shoqëria "ASL" sh.p.k.

Regjistruar si subjekt me të dhënat:

NUIS L81310025T; Nr. Licence NZ. 7703

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:

"Godinë banimi dhe shërbimi 11 kat me 2 kate parkim nëntokë", në pronë të znj. Nadire Kepi.

ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE:

Rruga "Kongresi i Manastirit", Njësia Administrative nr. 3, Tiranë.

AFATIKOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË:

60 muaj

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Sipërfaqja e truallit që zhvillohet

4 574 m²

Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura

1 235 m²

Numri i kateve mbi tokë

11 kate

Numri i kateve nëntokë

2 kat

Lartësia e strukturës

41 m

KONDIKIONE TEKNIKE:

Distanca e godinës nga kufiri i pronës:

Veri:

4.5 m - 5.2 m për volumnin 11 kat

Jug:

Kallkan në kufi të pronës; 5.1 m - 14.5 m; 7.2 m për volumnin 11 kat

Lindje:

8.2 m dhe 8.3 m për volumnin 11 kat

Perëndim:

34.4 m dhe 37.5 m për volumnin 11 kat

Distanca e godinës nga trupi i rrugës:

Veri:

4.0 m - 4.3 m për volumnin 11 kat

Lindje:

1.9 m - 2.0 m për volumnin 11 kat

KONDIKIONE TË VEÇANTA:

2 kat parkim nëntokë

LEJA E NDËRTIMIT JEPET ME KËTO KUSHTE:

Të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e strukturës, si dhe treguesit e zhvillimit.

Të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratur dhe grafikut të punimeve.

Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër ambienti përreth.

Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit të miratur të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime në rrjetin publik.

Të respektohen normat dhe standartet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë.

Gjatë fazave të ndërtimit do të kryhen kontrole dhe do të depozitohen pranë autoritetit vendor nga subjektet e licensuara në fushën e mbikqyrjes së punimeve të ndërtimit dhe Autoriteti Vendor verifikon konformitetin e akteve të kontrollit sipas legjislacionit në fuqi.

Në shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në refuzim të saj.

Afati i fillimit të punimeve është 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj leje.

Kjo leje është e vlefshme për një periudhë **60 (gjashtëdhjetë) mujore** nga data e lëshimit të saj, referuar grafikut të punimeve.

Çdo kusht tjetër i përcaktuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë, për miratimin e lejes së ndërtimit.

KRYETAR

2018.10.2

4 12:05:37

+02'00'

Erion VELIAJ

Miratoi:

D. Baboçi: Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

F. Pashako: Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

E. Murtaj: Përgjegjës i Sektorit të Sekretariatit Teknik

M. Sotiri: Specialist i Sektorit të Sekretariatit Teknik

G. Gjika: Jurist i Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve

Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al



LEJE NDËRTIMI

Nr. Prot. E-29298/9

Miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. E-29298/7, datë 04.03.2019

ZHVILLUES

Shoqëria "ASL" sh.p.k.

SUBJEKT NDËRTUES

Shoqëria "ASL" sh.p.k.

Regjistruar si subjekt me të dhënat:

NUIS L81310025T; Nr. Licence NZ. 7703

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:

"2 Godina banimi, shërbimi dhe hoteleri, 11 kat me 2 kat parkim nëntokë", në pronë të znj. Nadire Kepi

ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE:

Rruga "Kujtim Laro", Njësia Administrative nr. 3, Tiranë

AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË:

60 muaj

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Sipërfaqja e truallit që zhvillohet

3 302 m²

Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura

891 m²

Numri i kateve mbi tokë

11 kat

Numri i kateve nëntokë

2 kat

Lartësia e strukturës

40.65 (godina 1) dhe 41.4 m (godina 2)

KONDIKIONE TEKNIKE:

Distanca e godinës nga kufiri i pronës:

Veriu: 0.0 m (faqe kallkan) për volumnin 11 kat (godina 2)
19.2 m për volumnin 11 kat (godina 1)

Jugu: 0.1 m (faqe kallkan) për volumnin 11 kat (godina 2)
4.1 m për volumnin 11 kat (godina 1)

Lindja: 0.0 m (faqe kallkan) dhe 7.3 m për volumnin 11 kat (godina 1)
8.3 m për volumnin 11 kat (godina 2)

Perëndimi: 13.6 m për volumnin 11 kat (godina 1)

Distanca e godinës nga trupi i rrugës:

Lindje: 1.7 m për volumnin 11 kat (godina 2)

KONDIKONETË VEÇANTA:

2 kat parkim nëntokë

LEJA E NDËRTIMIT JEPET ME KËTO KUSHTE:

Të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e strukturës, si dhe treguesit e zhvillimit.

Të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratuar dhe grafikut të punimeve.

Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër ambienti përreth.

Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit të miratuar të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime në rrjetin publik.

Të respektohen normat dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë.

Gjatë fazave të ndërtimit do të kryhen kontrole dhe do të depozitohen pranë autoritetit vendor nga subjektet e licensuara në fushën e mbikqyrjes së punimeve të ndërtimit dhe Autoriteti Vendor verifikon konformitetin e akteve të kontrollit sipas legjislacionit në fuqi.

Në shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në refuzim të saj.

Afati i fillimit të punimeve është 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj leje.

Kjo leje është e vlefshme për një periudhë **60 (gjashtëdhjetë) mujore** nga data e lëshimit të saj, referuar grafikut të punimeve.

Çdo kusht tjetër i përcaktuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë, për miratimin e lejes së ndërtimit.

KRYETAR

2019.03.18

15:20:12

+01'00'

ERION VELIAJ

Miratoi:

D. Baboçi: Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

F. Pashako: Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

E. Murtaj: Përgjegjës i Sektorit të Sekretariatit Teknik

M. Sotiri: Specialist i Sektorit të Sekretariatit Teknik

G. Gjika: Jurist i Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve



BASHKIA
TIRANË

LEJE NDËRTIMI PËR NDRYSHIM ZHVILLUESI DHE SUBJEKTI NDËRTUES

Nr. Prot. X-6411/3

Miratur me Vendim të Kryetarit të Bashkisë X-6411/2

ZHVILLUES DHE SUBJEKT NDËRTUES
Regjistruar si subjekte me të dhënat:

Shoqëria "ASL" sh.p.k.
NUIS L81310025T; Nr. Licence NZ. 7703

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:
Miratur me vendim nr. prot. X-18843/7
datë 24.10.2018.

"Godinë banimi dhe shërbimi 1 dhe 9 kat me 2 kate parkim nëntokë dhe godinë banimi dhe shërbimi 3 dhe 9 kat me 2 kate parkim nëntokë", në pronë të familjes Kokonozi, Uznova, Suzana Shatku dhe Lindita Pocesta.

ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE:

Rruga "Kongresi i Manastirit", Njësia Administrative Nr. 3, Tiranë

AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË:

60 muaj (sipas lejes së ndërtimit , miratur me vendimin nr. prot. X-18843/7, datë 24.10.2018)

TË DHËNATË PËRGJITHSHME :

Sipërfaqja e truallit që zhvillohet
Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura
Numri i kateve mbi tokë
Numri i kateve nëntokë
Lartësia e strukturës

6081.06 m²
2365 m²
1, 3 dhe 9 kate
2 kate
34. 4 m

KONDIKIONE TEKNIKE:

Kondicionet urbane, projekti teknik dhe kushtet e tjera të lejes së ndërtimit, miratur me vendimin nr. X-18843/7, datë 24.10.2018, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, mbeten të pandryshuara.

KONDIKONETË VEÇANTA:

2 kat parkim nëntokë

LEJA E NDËRTIMIT JEPET ME KËTO KUSHTE:

Të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e strukturës, si dhe treguesit e zhvillimit.

Të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratur dhe grafikut të punimeve.

Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër ambienti përreth.

Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit të miratur të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime në rrjetin publik.

Të respektohen normat dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë.

Gjatë fazave të ndërtimit do të kryhen kontrolle dhe do të depozitohen pranë autoritetit vendor nga subjektet e licensuara në fushën e mbikqyrjes së punimeve të ndërtimit dhe Autoriteti Vendor verifikon konformitetin e akteve të kontrollit sipas legjislacionit në fuqi.

Në shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në refuzim të saj.

Afati i fillimit të punimeve është 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj leje.

Kjo leje është e vlefshme për një periudhë **60 (gjashtëdhjetë) muajore** sipas lejes së ndërtimit të miratur me vendimin nr. prot. X-18843/7, datë 24.10.2018

Çdo kusht tjetër i përcaktuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë, për miratimin e lejes së ndërtimit.

KRYETAR
2019.04.05

 16:43:44
+02'00'

ERION VELIAJ

Miratoi:

D. Baboçi: Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

F. Pashako: Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

G. Gjika: Jurist i Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve

Griselda
Gjika